

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas tre vitesh, SHBA rikthen ambasadorin në Tiranë, Eric Wendt dorëzon kredencialet te Begaj - Informo hu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/pas-tre-vitesh-shba-rikthen-ambasadorin-ne-tirane-eric-wendt-dorezon-kredencialet-te-begaj/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 07:56:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 07:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a082bde44ed88a1552285ccad653d4235c174e2378c9b757bd0cffde192d7560
TEKSTI	c56784e7a20f21ac5f7d271796902204ccd5070387345757e2847695e9dc9f7a
PAMJA	c804a03ba20765a42807b44fe1bc87190b218b8e78501e097ac034889b5d49d7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f08103610dfc722f3a7c492fc517744aa05d384ae5fbbc9bd749eb8e3eececf2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5ef72e280ad02d10fcef52ca02446c3f1a387185640f8c3107dbc4e00e7b78
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f08103610dfc722f3a7c492fc517744aa05d384ae5fbbc9bd749eb8e3eececf2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


YOU ARE AT: Home » Pas tre vitesh, SHBA rikthen ambasadorin në Tiranë, Eric Wendt dorëzon kredencialet te Begaj

KRYESORE

Demo

Pas tre vitesh, SHBA rikthen ambasadorin në Tiranë, Eric Wendt dorëzon kredencialet te Begaj

SEPTEMBER 26, 2026



Pas një periudhe gati trevjeçare pa një ambasador të emëruar, Shtetet e Bashkuara rikthejnë përfaqësimin e plotë diplomatik në Shqipëri. Eric P. Wendt do të dorëzojë këtë të shtunë letrat kredenciale te Presidenti Bajram Begaj, në një ceremoni të planifikuar për orën 11:00.

Pas ceremonisë së dorëzimit të kredencialeve, Presidenti Begaj dhe ambasadori i ri amerikan pritet të zhvillojnë edhe një takim kokë më kokë.

Wendt pason Yuri Kim, e cila përfundoi mandatin e saj në Shqipëri në qershor të vitit 2023. Gjatë periudhës së mëposhme, drejtimi i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë është mbajtur nga Nancy VanHorn në cilësinë e të ngarkuarës me punë.

Eric Wendt u nominua nga Presidenti Donald Trump për postin e ambasadorit të SHBA-së në Shqipëri dhe u konfirmua nga Senati amerikan në gusht. Të dhënat e publikuara pas konfirmimit e përshkruajnë atë si një ish-gjeneral-lejtnant të Ushtrisë amerikane, me më shumë se 34 vite shërbim ushtarak.

Një pjesë e rëndësishme e karrierës së tij është zhvilluar në Forcat Speciale amerikane, ndërsa detyra e tij e fundit në shërbimin aktiv ishte ajo e komandantit të Komandës së Operacioneve Speciale të NATO-s. Në këtë pozicion, Wendt drejtoi forcat speciale të vendeve aleate të angazhuara në strukturën e NATO-s.

Gjatë dëgjësës së tij në Komitetin e Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit në maj, Wendt paraqiti prioritetet që synon të ndjekë gjatë mandatit në Shqipëri. Në fokus janë lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, lufta kundër trafikut të drogës, si dhe forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike.

Në të njëjtën dëgjësë, Wendt shprehu mbështetje për SPAK-un dhe bashkëpunimin e tij me agjencitë amerikane të zbatimit të ligjit. Ai e lidhi rëndësinë e këtij bashkëpunimi me ruajtjen e pavarësisë së institucionit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet politike.

Me marrjen zyrtare të detyrës, Wendt do të jetë ambasadori i ri i SHBA-së në Tiranë, duke i dhënë fund periudhës së përfaqësimit amerikan në nivelin e të ngarkuarit me punë. Ambasada amerikane në Tiranë vijon të jetë përfaqësia diplomatike e SHBA-së në Shqipëri.

Në kalendarin e angazhimeve të tij në Tiranë përfshihet edhe pritja zyrtare e 2 tetorit, ku pritet të marrin pjesë përfaqësues të politikës shqiptare nga të gjitha krahët.

Eric Wendt SHBA

Postimet e reja

Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi/ Policia...

SEPTEMBER 26, 2026

Pasojat e luftës në Iran, BE u bën thirrje shteteve:...

SEPTEMBER 26, 2026

Pas tre vitesh, SHBA rikthen ambasadorin në...

SEPTEMBER 26, 2026

Të shtëna me armë në një kafene në Athinë,...

SEPTEMBER 26, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Slloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjona: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.